Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0497

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (LPP) në përbërjenVjosa Gradinaj-Mexhuani Kryetare,duke vendosur lidhur me ankesën e operatorit ekonomik (OE)"Proglobal"SH.P.K (e regjistruar me numër të protokolli 497/23) e parashtruara kundër Vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit" i cili identifikohet me numër të prokurimit 214-23-3593-2-2-1, inicuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga cilësia e autoritetit kontraktues (AK) me 24.08.2023 mori:

Vendim

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "Proglobal" SH.P.K.(Nr.protokolli 2023/0497) e datës 17/07/2023, kurse Anulohet vendimi i AK Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me aktivitetin e prokurimit "Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit" me numër të prokurimit 214-23-3593-2-2-1, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP-së.

3.Lejohetkthimi i tarifave të ankesave në shumën e deponuar ashtu që obligohen operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi, të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 18.04.2023, Ministria e Punëve të Brendshme duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit" i cili identifikohet me numër të prokurimit 214-23-3593-2-2-1.

Me 29.06.2023, AK (me të dhëna si me sipër) përmes Njoftimit, ka publikuar vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të sipër shënuar në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Me 03.07.2023, OE "Proglobal" SH.P.K. kundër vendimit të cituar si më sipër ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 06.07.2023.

Me 17.07.2023, OE i pakënaqur me vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim ka parashtruar ankesë në OSHP e cila është regjistruar (me numër protokolli 497/23).

-*Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-*

OSHP konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e kane statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Paneli Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 02.08.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues "Proglobal" SH.P.K. të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Konstatohet në vijim, se raporti i cituar si më sipër është pranuar nga të gjitha palët, me ç 'rast AK me 04.08.2023, ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit, ndërsa OE "Proglobal" SH.P.K. me 03.08.2023, ka deklaruar se pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe ka konvokuar seancën e shqyrtimit kryesor me 23.08.2023 me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes. Pohimet e palëve, provat e administruara dhe shpjegimet e ekspertit janë evidentuar në procesverbalin e kësaj seance, të cilat në ketë rast për nevojat e këtij vendimi konstatohet (shkurtimisht), se të dyja palët kanë qëndruar prapa pretendimeve të tyre, me ç 'rast Ankuesi e ka pranuar raportin e ekspertit shqyrtues, përderisa përfaqësuesi i AK ka deklaruar se nuk pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues.

-Përfaqësuesi i OE-së ankuese, në seancën për shqyrtim kanë deklaruar se qëndrojnë në tersi pranë ankesës të parashtruar me datën 17.07.2023, pajtohen me mendimin e ekspertit qe lënda te kthehet ne rivlerësim sepse sipas tij/saj AK pa vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike përfshirë provat dhe dështmitë e bashkangjitura në ofertë në relacion me DT dhe NJK ashtu siç e obligon neni 59 i LPP, në mënyrë të kundërligjshme e ka eliminuar ofertën tonë. OE me tej ka sqaruar se tek përshkrimi i kontratave të realizuara, në listën e kërkuar nga AK, gjatë bartjes së të dhënave kishin lëshuar një gabim teknik në përshkrimin e datës së përfundimit të kontratës, e cila ishe kontraktuar ndërmjet ankuesit dhe "Raiffaisen Bank Kosova" ashtu që në vend të datës 12.05.2020 si datë e përfundimit të kontratës kanë përshkruar datën 18.01.2020. Megjithatë ankuesi thekson se ky gabim ka qenë lehtë i verifikueshëm nga AK, për arsye se në ofertën e tij/saj ka qenë e bashkëngjitur "kontrata" në të cilën është përcaktuar saktë kohëzgjatja fillimi dhe përfundimi i saj, e cila sipas dështmive të kërkuara AK s rezulton të jetë pikërisht në përputhje me periudhën tri vjeçare sipas DT. Por sërish AK-MPB edhe pse ka pasur mundësitë ligjore përfshirë nenin 59,72 të LPP lidhur me nenin 38, pika 4 të Rregullores nr.001/2022, Për Prokurimin Publik i cili shprehimisht përcakton se "Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sipas ankuesit sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon/nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga AK dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura", Andaj AK, sipas ankuesit fillimisht ka qenë e obliguar që të njoftojë operatorin ekonomik që t'i jap informacione shtesë dhe të qartësojë përmbajtjen e gabimit e cila i referohet datave sipas përshkrimit të shpjeguar si më sipër dhe jo të eliminoj në mënyrë të kundërligjshme ofertën tonë, e cila i plotëson të gjitha kërkesat e DT dhe NJK. Kurse sa i për ofertuesve tjerë më të lirë ankuesi ka shtuar se me të drejtë janë eliminuar nga AK si të papërgjegjshëm, kurse me çmimin e ofruar nga

OE i rendituri i parë çmimi më i lirë, nuk ka mundësi te behet (mbushja, matja hidrostatike, etj) andaj e ka mbështuar AK rreth eliminimit të tyre.

Ekspertja shqyrtuese, në seancën për shqyrtim ka pohuar se qëndron mbrapa ekspertizës, duke shtuar se eliminimi i ankuesit nga AK për këtë aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren për Prokurimin Publik. OE ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme lidhur me kontratat e realizuar, referenca, transaksionet bankare si dhe kontrata me "Raiffeisen Bank" dhe po ashtu ka dorëzuar edhe dëshmi për projekte te tjera të cilat e plotësojnë kërkesën e AK-së. AK e ka eliminuar Ankuesin me arsyetimin se gjoja kontrata me "Raiffeisen Bank" ka përfunduar me **18.01.2020 sipas listës së prezantuar nga OE** (Referuar Njoftimi për Kontratë **13.04.2023)** dhe nuk mund të pranohet si e mirëqenë. Ekspertja Shqyrtuese ka pohuar se ankuesi në ofertën e tije përveç listës ka ofruar si dëshmi edhe kontratën kontestuese nga AK në të cilën figuron si datë e përfundimit të saj **12.05.2023**, në këtë rast nëse AK ka pasur paqartësi se kur ka përfunduar kjo kontratë është dashur të kërkojë sqarime konfrom nenit nenit 59.2 të LPP i cili parasheh cituar "*Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues*". Po ashtu referuar nenit 45.30 të RRPP i lejohet AK "Verifikimin e përshtatshmërisë, dhe nëse është e aplikueshme, kualifikimeve të ofertuesit, bëhet përmes Letrës standarde B45 "Kërkese për sqarimin e tenderit" përmes platformës elektronike". Bazuar nga të lartëcekurat, Ekspertja konsideron se kontrata e prezantuar në ofertë nga ankuesi ka vlerë argumentuese dhe provuese me shumë se sa një listë e plotësuar nga vetë OE.

Lidhur me OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet, sa i përket pretendimit të ankuesit për çmime jo normalisht të ulëta, për ofertuesin më të lirë, Ekspertja sqaron shkurtimisht se bazuar në RRPP, nuk plotësohet kriteri për aplikimin e kësaj formule, pasi që nuk ka pasur tri oferta të përgjegjshme, rrjedhimisht njërit OE i mungon siguria tenderit, megjithatë në këtë rast mund te konsiderohet se kemi çmime manipulative ngase ofertuesi i parë ka ofertuar me çmim 10,280.16€ për dallim nga dy OE tjerë pjesëmarrës 106,510.76€ dhe 106,388.80€.

Përfaqësuesi i AK- ka deklaruar gjatë seancës për shqyrtim se përmes letrës standarde ankuesi ishte njoftuar se është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si në vijim : Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar Dëshmi të mjaftueshme siç është kërkuar në Dosjen e tenderit (kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe profesional) 9.1 & 9.2 pika 2 4. AK-MPB sqaron se këtë vendim e ka marr duke u bazuar në nenin 10.1 të Rregullorën 001/2023, në rast se lista e kontratave nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar në DT, të refuzohet tenderi pa kërkuar informata shtesë. Kurse lidhur me ofertuesit tjerë ka deklaruar se ka vepruar komform autorizimeve që ia njeh LPP respektivisht neni 61 dhe 41.10 pika b e RRPP.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe veprimet e ndërmarra nga palët (OE dhe AK), Paneli Shqyrtues ka konstatuar se:

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK e ka eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet kur ka konstatuar se nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme që tregojnë se i përmbush kërkesat minimale të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, Paneli sqaron se kundrejt kësaj kërkese/dëshmie, parashtruesi i ankesës se bashku me oferte ka prezantuar si dëshmi kontrata të realizuara me subjekte të ndryshëm të dëshmuara me referenca dhe transaksionet bankare dhe po ashtu në ofertë ka të bashkangjitur edhe kontratën "kontestuese" nga AK, e lidhur ndërmjet Ankuesit dhe "Raiffeisen Bank" e datës 16.05.2019.

Për më tepër nga shkresat e lëndës fare lehtë vërtetohet fakti se në përmbajtjen e "kontratës kontestuese" të cituar si më sipër, figuron si datë e fillimit të ekzekutimit të kësaj kontrate dt.**13.05.2019,** kurse data e përfundimit të saj figuron të jetë **12.05.2022**, vlen të cekët në shkresat e kësaj lënde po ashtu janë bashkangjitur si provë dëshmuese për vijueshmërinë e kësaj kontrate edhe pas datës "18.01.2022" siç janë faturat për punë e kryera të leshura për "Raiffasen Bank", pagesat kundrejt tyre të dëshmuara në qarkullimet zyrtare bankare të Ankuesit pra edhe pas datës 18.01.2020 (të cilën sipas listës së prezantuar AK, ka zgjedhur ta konsideroj të mirëqenë në relacion me dokumentet tjera të prezantuara nga ankuesi si dëshmi të cituara si më sipër). Andaj bazuar në sqarimet e mësipërme, Paneli shqyrtues ia fali besimin ekspertes shqyrtuese e cila edhe në seancën dëgjimore 23.08.2023, konfirmoj se Ankuesi ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme (kontrata, referenca, transaksione bankare) të cilat e plotësojnë dhe tejkalojnë kërkesën e DT të vendosur nga AK.

Lidhur me arsyetimin e AK, për eliminimin e ofertuesit të parë se i njëjti ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta apo për 10 herë me te lira se ofertuesit tjerë të cilët sipas AK janë me çmime reale dhe të përafërta. Lidhur me këtë Ekspertja shqyrtuese, edhe pse në raportin e saj ka konstatuar se mund të jenë ofruar çmime manipulative nga ofertuesi i parë (me çmim më të lirë), ka theksuar se nuk janë përmbushur kushtet për formulën për çmime jo-normalisht të ulëta sipas nenit 41.3 të RRPP, ngase për këtë aktivitet nuk ka tenderues të përgjegjshëm ashtu siç kërkohet me RRPP që minimumi të jenë 3 ofertues.

Paneli shqyrtues lidhur me këtë të gjetur të ekspertes shqyrtuese sqaron se AK (përveç pikës 41.3 të RRPP) bazuar në neni 61 të LPP lidhur me nenin 41.4 të Rregullores për Prokurim Publik cituar: "*Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore", autoritetet kontraktuese mund të*

vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së". Andaj, nga shkresat e lëndës vërehet se AK kishte aplikuar këtë të drejtë sipas nenin 61 dhe 41.4 të RRPP dhe kishe kërkuar sqarime nga ofertuesi i parë, lidhur me çmimet e ofruara në ofertë si "jo normalisht të ulëta", mirëpo nga arsyetimi i dhënë i ofertuesit, nuk ishte bindur se i njëjti kishte ofertuar me çmimet e tregut apo nëse i njëjti do të kishte mundësi ta ekzekutonte kontratën e prokuruar, kjo për faktin se sipas tij/saj diferenca në çmim ndërmjet OE-ve pjesëmarrës rezulton të jenë ofruar si në vijim: Oferta me çmimin më të lirë përmbante vlerën 10,280.16€, kurse oferta e ofertueseve të dytë dhe të tretë përmbanin vlerën e përafërt 106,388.80€ dhe 106,510.76€. AK po ashtu gjatë seancës së mbajtur, lidhur me këtë të gjetur të raportit shqyrtues, theksoi faktin se i njëjti kishe vepruar sipas LPP duke u ndërlidhur me nenin 41.10 pika b të RRPP cituar : "Autoriteti kontraktues ka të drejtë të merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik dhe nëse sqarimi nuk mjafton, ka të drejtë të refuzoj tenderin dhe në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulet", brenda dy dite nga data e vendimit, të cilat veprime sipas dëshmive të prezantuara në e-prokurim rezultojnë të jenë të kryera nga AK". Paneli shqyrtues lidhur me këtë konstaton, se OE i eliminuar në përgjigjën e dhënë për AK të datës 26.05.2023, nuk ka ofruar argumente te mjaftueshme për përgjegjshmërinë e tij lidhur me ekzekutimin e kësaj kontrate sipas çmimeve të ofruara, andaj mbështet arsyetimin e dhënë nga AK.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe jo të shoh ligji në mënyrë selektive, andaj bazuar ne pretendimet ankimore dhe atë qe u përshkrua si me larte, paneli vendosi qe kjo procedure e prokurimit të kthehet ne ri vlerësim me qellim që të vlerësohen në mënyrë te drejte kërkesat e FDT dhe njoftimit për kontratë kundrejt dëshmive të ofruara në ofertat e OE pjesëmarrës në këtë aktivitet, duke vepruar në harmoni me nenit 1,7, 59, 60, 69 dhe 72 të LPP lidhur me nenin 38.4 të RRPP.

Paneli shqyrtues sqaron se gjatë rivlerësimit Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh edhe nenin 59 paragrafi 4 të LPP lidhur me nenin 45.2.1 të RRPP se edhe nëse do të kishte lëshime të vogla eventuale, që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara me njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit, për panelin shqyrtues do të konsideroheshin jo të rëndësishme në raport me interesin publik dhe fondet publike, e për të cilat fonde dhe burime publike, autoritet kontraktuese janë të obliguara ti përdorin në mënyrë ekonomike. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së pasi që dihet që qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efikase transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimin të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese ne Republikën e Kosovës.

- Përfundim -

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin shqyrtues dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të GOE "Proglobal Sh.P.K & Pastor Kosova" detyrojnë Panelin, që ky aktivitet i prokurimit në ketë rast t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit për ti përmbushur qëllimet parësore të LPP, sikurse sanksionohen ato me nenin 1, të Ligjit të cituar.

Prandaj duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 6, të Rregullorës së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **PROGLOBAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: